

## BASHKIA TIRANË AGJENCIA E RINISË

### “Njoftim per publikim per marrje ambjenti me qira”

Në zbatim të ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenit 7, të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar), ligjit Nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, VKB-së Nr. 125, datë 22.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2024”, memo-s së Drejtorisë së Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Liçensimit me nr. prot. 31316, datë 17.10.2016, me lëndë: “*Mbi procedurën e marrjes me qira të ambienteve për nevoja të Agjencia e Rinisë*”, kërkesat e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave me nr.8623/5prot., datë 06.10.2023 memo-s së Agjencisë së Rinisë me nr.94 prot., datë 02.02.2024, me lëndë: “*Kërkesë për Miratim*”, Agjencia e Rinisë, Bashkia Tiranë shpall thirrjen ” Mbi procedurën e marrjes me qira të ambienteve për nevoja të Bashkisë Tiranë”.

### **Kriteret, specifikimet e ambientit dhe dokumentacioni që kërkohet nga ofertuesi qiradhënës.**

Agjencia e Rinisë kërkon të marrë me qira ambient të përshtatshëm *për sistemimin e kasafortës për administrimin e vulave (sipas VKM nr.390, dt 06.08.1993), raftë metalike dhe kutitë e kartonit sipas standarteve arkivore*, me këto kriteret dhe specifikime si më poshtë vijon:

- a) Duhet të ketë certifikatë pronësie.
- b) Të jetë pranë godinës së Agjencisë së Rinisë me adresë: Rruga “Abdi Toptani” (jo më larg se 500m).
- c) Të ketë kushte të plota për të qenë e aksesueshme nga Agjencia e Rinisë.
- d) Të ketë ndriçim të përshtatshëm.
- e) Sipërfaqja e ambjentit të jetë nga 30 m<sup>2</sup> - 35 m<sup>2</sup>

#### **1. Oferta e qiradhënësit duhet të jetë e shoqëruar me:**

- Kërkesa e subjektit/individit për pjesëmarrje në konkurrim;
- Deklarata e hollësishme për vënien në funksionim të objektit;
- Gent-plani i pasurisë.
- Fotokopje e noterizuar e certifikatës së pronësisë dhe kartelës së pasurisë.
- Përshkrim i gjendjes së ambientit.
- Përshkrim i gjendjes së paisjeve të tij, nëse ka brenda ambjentit objekt i qiradhënies.

- Fotokopje e kartës së identitetit të ofertuesit qiradhënës.
- Ekstrakt i QKR-së (nqs është subjekt tregtar).
- Oferta e qiradhënësit duhet të specifikojë çmimin mujor të qirasë.
- Të interesuarit (ofertuesit qiradhënës) duhet të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin brenda datës 08.03.2024 në Protokollin e Agjencisë së Rinisë.
- Kontrata e qiramarrjes quhet e lidhur dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga Agjencia e Rinisë (Qiramarrësi) dhe Ofertuesi (qiradhënës) i shpallur fitues.

## ***2. Oferta fituese do të jetë:***

- Oferta e cila, në bazë të kriterëve dhe kërkesave të përcaktuara në stendat e Institucionit “Njoftimin për Publikim” ose “Website-in Zyrtar” të Bashkisë Tiranë plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktor për objektin e kontratës së qiramarrjes me çmimin më të ulët ose oferta ekonomikisht më e favorshme.